

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË PESHKOPI

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Peshkopi**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.07.2011 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 171, datë 18.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 950/7, datë 18.12.2014, i ka rekomanduar z. Ilir Krosi, Kryetar i Bashkisë Peshkopi, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetjet nga auditimi: Nuk janë marrë masa për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”. Është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik por nuk ka funksionuar, pasi titullari i Bashkisë, nuk ka caktuar koordinatorin e riskut dhe nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij, nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peshkopisë të nxjerr urdhër për emërimin e koordinatorit të riskut dhe për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e rregullave mbi administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme, të marrë masa për funksionimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Brenda datës 31.1.2015

2. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Ndhimave Ekonomike, ka trajtuar me ndihma ekonomike familjet në nevojë por listat emërore, nuk janë konfirmuar nga Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të komunave; nëse kanë përfituar ose jo pronësi mbi tokën sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “*Për tokën*”, i ndryshuar dhe për bonitetin e saj, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*”, i ndryshuar.

2.1.Rekomandimi: Zyra e Ndhimës Ekonomike pranë Bashkisë, të marrë masa për vlerësimin e praktikave të dhënies së ndihmave ekonomike, duke konfirmuar më parë listat emërore të familjeve përfitues, nga Zyrat e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës të Komunave ku kanë banuar më parë.

Brenda datës 31.1.2015

3. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka kryer kontrole në subjektet taksa pagues mbi lëshimin ose jo të kuponëve tatimore, mbi mbajtjen e librave të xhiros etj., veprime këto në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “*Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore*”, pika 10.

3.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e planit vjetor të kontroleve në drejtimet e përcaktuara sipas kërkesave të Udhëzimit të Përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 06.02.2007, në bashkëpunim me Policinë e Bashkisë.

Brenda datës 31.1.2015

4. Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se për vitet 2012 dhe 2013, kanë ushtruar aktivitet pa qenë të regjistruar, 13 subjekte taksa pagues. Mos regjistrimi i këtyre subjekteve në QKR, ka sjellë mos llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimeve për kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore, llogaritur në vlerën 1,218,558 lekë, shkelje këto e kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar neni 40 dhe 41, ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore”, i ndryshuar.

4.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në bashkëpunim me Policinë e Bashkisë, të marrë masa dhe të ndjekë hapat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve të kontributeve për Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore në vlerën 1,218,558 lekë, nga 13 subjekte që kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar.

Brenda muajit 31 .03. 2015

5. Gjetjet nga auditimi: Konstatohet se deri më datën 30.9.2014, nuk është arkëtuar vlera **9,316,000 lekë**, për 3 lloje taksa e tarifa të popullatës përkatësisht; taksa për ndërtesën, në vlerën 2,316,000 lekë, tarifa e pastrimit për vlerën 5,282,000 lekë dhe tarifë ndriçimi për vlerën 1,718,000 lekë.

5.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e Bashkisë, të marrë masat dhe të ndjekë hapat ligjore e administrative për arkëtimin nga debitorët të vlerës 9,316,000 lekë, si diferencë e pa paguar për taksat dhe tarifatat nga banorët.

Brenda datës 31.6.2015

6. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Taksave Vendore, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për arkëtimin nga subjekte të biznesit të vogël të vlerës debitorë për 6,541,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nenet 89, 90 dhe 91.

6.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore, në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe Policinë e Bashkisë të marrë masa dhe të ndjekë hapat ligjorë administrativë për arkëtimin nga subjektet taksa pagues, të detyrimeve debitorë për vlerën 6,541,000 lekë.

Brenda datës 31.6.2015

7. Gjetjet nga auditimi: Në përbërje të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor (INUV), nuk janë emëruar specialistë të fushës; INUV nuk ka marrë masat e nevojshme ligjore për ndërtimet pa leje, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoratin ndërtimor”, i ndryshuar, neni 5, 11, 12, 13 dhe 13, VKM 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar e ai vendor” pikat 4, 6 dhe 5.

7.1.Rekomandimi: Titullari i bashkisë, të marrë masat për riorganizimin e strukturës së INUV dhe përmbushjen e detyrave ligjore sipas kërkesave të ligjit nr. nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoratin ndërtimor” i ndryshuar.

Brenda datës 28.2.2014

8. Gjetjet nga auditimi: U konstatua se me VKM nr. 1533, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të pa luajtshme shtetërore në Bashkinë Peshkopi të Qarkut Dibër”, kanë kaluar në përdorim dhe pronësi 1445 prona.

Këto prona nuk janë regjistruar pranë ZVRPP Dibër, veprime këto në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” neni 45, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, me kreun IV neni 18, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, ”Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, neni 18 si dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

8.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Peshkopi të marrë masa për regjistrimin e pronave që me Vendim të Këshillit të Ministrave, i kalojnë në pronësi të bashkisë duke verifikuar statusin juridik të tyre në terren dhe më pas të procedohet për regjistrimin e tyre në ZVRPP.

Brenda datës 31.6.2015

9. Gjetjet nga auditimi: U konstatua se në vitin 2011, janë vjedhur vlera inventariale të bashkisë në shumën 169.038 lekë, të cilat janë shkarkuar nga kontabiliteti pa miratim të Këshillit të Bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore“ i ndryshuar, neni 8, paragrafi II/c dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. IV, pikat 87, 89, 93.

9.1.Rekomandimi: Titullari i bashkisë të marrë masa dhe të analizojë fenomenin duke proceduar sipas ligjit ndaj personave përgjegjës.

Brenda datës 31.1.2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Bashkia Peshkopi të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore e përmbartimore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit me **vlerën 6,838,977 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Gjetjet nga auditimi: Nuk është llogaritur dhe arkëtuar penalteti për vlerën **2,483,421 lekë** ndaj subjekteve që nuk kanë dorëzuar në kohë punimet sipas kontratave, konkretisht subjekti “Afrimi” Shpk, për objektin: “Rikonstruksion & Sistemim Oborri Shkollat 9/vjeçare D. Gashi & S.Alliu” dhe subjekti “Gjoka Konstruksion” shpk për objektin: “Sistemim asfaltim rrugë të brendshme blloku i banimit Lagje Kamen”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar neni 850.

1.1.Rekomandimi: Për vlerën **2,483,421 lekë**, për sa nuk është llogaritur dhe arkëtuar penaltet për punimet të pa dorëzuar sipas afatit të kontraktuar:

Subjekti “A...” shpk për 550,374 lekë;

Subjekti “Gj.K...” shpk për 1,933,047 lekë.

Brenda datës 31.3.2015

2. Gjetjet nga auditimi: Për vitet 2012 dhe 2013, janë paguar në 61 raste, paga për punë të kryer jashtë kohës normale të saj për vlerën **1,676,513 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 463, datë 16.6.2011 "Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore ", të ndryshuar dhe Udhëzimit të MF nr. 16, datë 20.7.2011 "Mbi zbatimin e VKM nr. 463 datë 16.6.2011".

2.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Peshkopi, të merren masat për arkëtimin e vlerës **1,676,513 lekë** për 61 raste të pagesave për punë të kryer jashtë kohës normale të saj, në kundërshtim me kërkesat ligjore në fuqi, sipas listës emërore të pasqyrës në faqen 30.

Brenda datës 31.6.2015

3. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Taksave Vendore, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për llogaritjen dhe arkëtimin e gjobës në masën 25 për qind të detyrimit të pa paguar për 120 subjekte, në vlerën **1,198,000 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 114.

3.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave Vendore e Bashkisë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës **1,198,000 lekë** nga 120 subjekte për sa nuk është llogaritur dhe arkëtuar masa e gjobës për detyrimet e pa paguara në afat, sipas listës emërore të pasqyrës në faqen 66.

Brenda datës 31.5.2015

4. Gjetjet nga auditimi: Janë lidhur 22 kontrata dhënie me qira të banesave për të pa strehët, sipas programeve sociale dhe nuk janë paguar detyrimet kontaktuale ndaj Bashkisë Peshkopi për vlerën **485,529 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9232, datë

13.05.2004 “Mbi programet sociale të strehimit për banorët në zonat urbane” dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar neni 850.

4.1.Rekomandimi: Bashkia Peshkopi të marrë masa për arkëtimin e vlerës **485,529 lekë**, sipas kontratave të lidhura me 22 personat fizikë, për sa nuk kanë paguar detyrimet kontraktuale, sipas listës emërore të pasqyrës në faqen 83, 84.

Brenda datës 31.3.2015

5. Gjetjet nga auditimi: Zyra e Taksave Vendore, nuk ka proceduar sipas kërkesave ligjore për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për 48 subjekte në vlerën **411,000 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 i ndryshuar, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, neni 70 dhe miratimeve me vendime të Këshillit të Bashkisë.

5.1.Rekomandimi:

Bashkia Peshkopi të marrë masa për arkëtimin e vlerës **411,000 lekë**, për 48 subjekte për taksat lokale të pa paguara, sipas listës emërore të pasqyrës në faqen 61-62.

Brenda datës 31.3.2015

6. Gjetjet nga auditimi: U konstatua se janë paguar shpenzime për telefonat celularë për 23 punonjës në vlerën **564,192 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”, pikat 9, 14 dhe 14 (*trajtuar më hollësisht në faqen 32-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1.Rekomandimi: Bashkia Peshkopi të marrë masa për arkëtimin e vlerës **564,192 lekë** për 23 punonjës për sa kanë përfituar pagesë për shpenzime celulari, sipas listës emërore të pasqyrave në faqet 33, 35, 36.

Brenda datës 31.5.2015

7. Gjetjet nga auditimi: U konstatua në një rast se personi fizik U. T., nuk ka paguar sipas kërkesave ligjore detyrimet për taksën e lejes së ndërtimit në vlerën **20,322 lekë**, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën i ndryshuar”.

7.1.Rekomandimi: Për vlerën **20,322 lekë** për sa personi fizik z. Urim Ternaku, nuk ka paguar sipas kërkesave ligjore detyrimet për taksën e lejes së ndërtimit

Brenda datës 31.3.2015

C. MASA DISIPLINORE

-Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, miratuar më datën 30.5.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, i rekomandojmë Titullarit të Institucionit që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”, ndaj 6 punonjësve si më poshtë:

-zj. R.H. me detyrë Përgjegjëse e Seksionit të Ndhmës dhe Çështjeve Sociale.

-Për shkelje të kërkesave të ligjit nr. 9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet sociale” dhe VKM nr. 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike“, pika 2/ç dhe 2/d. Në procedurat e dhënies së ndihmave ekonomike, nuk janë konfirmuar pranë Zyrrave të Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës të komunave, pronësia dhe boniteti i tokës për familjet e trajtuara me ndihma ekonomike.

-zj. Ç.Z. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës.

-Për sa janë paguar shpenzime për pagat e punonjësve për punë të kryer jashtë kohës normale të saj në 61 raste për vlerën 1,676,513 lekë me dëm ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 463, datë 16.6.2011 “Për disa shtesa ndryshime në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore” të ndryshuar dhe UMF nr. 16, datë 20.7.2011.

-Për sa janë paguar shpenzime për telefona celular për 23 punonjës në shumën 546,192 lekë me dëm ekonomik, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”, pikat 9, 14 dhe 14.

-Për sa nuk është llogaritur dhe arkëtuar kamat vonesë në dorëzimin e punimeve të kontraktuara në vlerën 2,483,421 lekë me dëm ekonomik përkatësisht për subjektin “A...” shpk për vlerën 550,374 lekë dhe “Gj.K...” shpk për vlerën 1,933,047 lekë, në kundërshtim me e kërkesave e kontratës të lidhur midis palëve dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar neni 850.

-Për sa janë shkarkuar nga kontabiliteti vlera inventariale në shumën 169,038 lekë të evidentuara të vjedhura, pa miratim të Këshillit të Bashkisë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 8, paragrafi II/c dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. IV, pikat 87, 89, 93.

-z. T.S. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Tatim Taksave.

-Për sa janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore për programimin, vjeljen dhe ndjekjen detyrimeve debitore ndaj subjekteve taksa pagues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, Udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” me ndryshime.

-z. R.G. me detyrë Inspektor i Taksave.

-Për sa janë konstatuar shkelje të procedurave ligjore për vjeljen dhe ndjekjen detyrimeve debitore ndaj subjekteve taksa pagues, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, Udhëzimit të MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” me ndryshime.

-z. H.ZH. ish Përgjegjës i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor.

-Për sa nuk është proceduar sipas kërkesave ligjore në 31 raste të ndërtimeve pa leje.

Në asnjë rast, nuk është vendosur masa e gjobës për shkeljen e konstatuar, ndërtim objekti pa leje ndërtimi, nuk është koordinuar me INUK, për prishjen e ndërtimeve pa leje, nuk janë bërë kallëzime penale në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoratin ndërtimor”, i ndryshuar, neni 5, 12 dhe 13 si dhe të VKM 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar e ai vendor” pikat 4, 6 dhe 5.

-z. S.L. me detyrë N/Kryetar i Bashkisë dhe Përgjegjës i Zyrës së Administrimit të Pronave dhe Strehimit.

-Përsa nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve për 22 kontrata dhënie me qira të banesave për të pa strehët sipas programeve sociale në vlerën 485,529 lekë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Mbi programet sociale të strehimit për banorët në zonat urbane” dhe ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar neni 850.

Përsa nuk janë kryer procedurat ligjore për regjistrimin e pronave që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë me VKM nr. 1533, datë 19.11.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Peshkopi të Qarkut Dibër”, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 i ndryshuar, "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit" neni 18, ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011.

-Titullari i Autoriteti Kontraktor, të vlerësojë shkallën e shkeljeve ligjore dhe shkallën e përgjegjësisë për Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në procedurat e prokurimit të fondeve publike të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe të marrë masat disiplinore nga “*vërejtje*” deri në “*largim nga detyra*”.

Për Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave: Kryetar- T.S. dhe anëtarët; Ç.Z., I. K., E.D..

Për Njësinë e Prokurimit: Juriste- A.B. dhe anëtarët; Xh.N., A.B., E.D., P.U.

Nga Bashkia Peshkopi, me shkresë nr. 63, prot, datë 14.01.2015, protokolluar në KLSH me nr.950/8 datë 16.01.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Josif Lile, Përparim Gjuzi dhe Din Zeneli më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT